ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KEK-24-10892-2-2-1& KEKO-24-342-221**

Sa i përket tenderit për: **Sherbimet gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeomekanike si dhe analizat laboratorike te qymyrit**

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

GOE: Geokos A&A O.P. ; Horn and Co. Analytics SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Nr.8, ARK, Karl Gega
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

+383-44-127-789
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Gent Muçolli
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë lider i grupit)

geokos.aa@gmail.com info@geokos-aa.com
(Adresa elektronike)

09.07.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)

O.P. Geokos A&A Prishtinë

(Nënshkrimi dhe vula)

Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., me date 21.10.2024 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: "Sherbimet gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeomekanike si dhe analizat laboratorike te qymyrit" si në vijim:

- ☐ Procedurë e hapur,
- ☐ Kontrate publike,
- ☐ Shërbim, Vlerë e mesme
- ☐ Vlera e parashikuar e kontratës: 106,959.39 euro
- ☐ Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimin më te ulët i tenderit të përgjegjshëm!

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve: 11.11.2024 ora:12:00, Vendi: Zyra e Prokurimit
Takimi për hapjen e tenderëve: 11.11.2024 ora:14:00 ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me date 23.01.2025 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe te eliminuar.

Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde te tenderuesit te pa përgjegjshëm (te eliminuar).

Me datë 28.01.2025, Kërkesa për ri-shqyrtim të vendimit te AK;
Me datë 04.02.2025, Vendimi i AK për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim;
Me datë 07.02.2025, Ankesë në OSHP, ankesa nr. protokolli 2025/0101;
Me datë 13.05.2025, Vendimi i OSHP-se, nr. 2025/0101, (ankesa e bazuar dhe rasti kthehet në Rivlerësim).
Me datë 26.06.2025, Njoftimi mbi vendimin e AK, Anulimi i tërësishëm i Aktivitetit të Prokurimit.
Me datë 29.06.2025, kemi paraqite Kerkese për ri-shqyrtim pran AK

Ndërsa me datë 08.07.2025, AK nxjerr vendim, ku refuzon kërkesën për rishqyrtim, por, që koha e nxjerrjes së vendimit është e jashtë afatshme, atëherë në mbështetje të nenit 109 të LPP-se, parashtrojmë Ankesë në OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderit është bere ne mënyre elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Te pa kënaqur me rezultatin përfundimtar, lidhur me njoftimin për tenderuesin e eliminuar dhe vendimit të AK për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, me datë 26.11.2024, brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkese për ri-shqyrtim ne pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK për rezultatin e aktivitetit në fjalë. (Bashkëlidhur me ketë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim te dorëzuar në AK, të dt.29.06.2025).

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Po ashtu edhe për mes kësaj Ankese, paraqesim pretendimet tona ankimore mbesin po të njëjtat, sepse në tersi qëndrojmë prapa kërkesës për rishqyrtim të paraqitur ne AK me dt.29.06.2025, për shakak se kemi qene të pa kënaqur me Vendimin e Autoriteti kontraktues **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a** dhe, në pajtim me nenin 109 të LPP-së parashtrojmë ANKESË kundër;

- **Vendimit të AK nr.4544, të datës 08.07.2025, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim;**
- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm- eliminuar) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit;**
- **Njoftimit te Vendimit te AK për anulimin e tërësishëm të aktivitetit të Prokurimit të datë 26.06.2024 dhe**

Pretendojmë se **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a**, përmes Zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, par. 1,2 dhe 3;
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 3;
- Neni 27, Dosja e tenderit, par. 1;
- Neni 51, Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, par 1 dhe 2;
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par. 4;
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, par 1, dhe 2.
- Neni 109, Afatet për Dorëzimin e Ankesës, paragrafi 1 dhe 2.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022, të prokurimit publik - versioni i konsoliduar (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.12 dhe 40.13;
- Neni 43, Ndërprerja e procedurave të prokurimit, par 43.5 dhe 43.7;
- Neni 97, Shkeljet e rënda, paragrafi 97.1, germa (d);(h) dhe (p).

III. Ne shkelje të vendimit të OSHP-se, nr. 2025/0101.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi i parë: (AK), me Vendimin nr. 4544, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga Operatorit Ekonomik (OE), duke e konsideruar atë të pabazuar.

Ky vendim i AK është i jashtëafatshëm, për shkak se, pavarësisht se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur brenda afatit ligjor nga OE më datë 29.06.2025, AK nuk ka marrë vendim për miratimin ose refuzimin e saj brenda afatit kohor të përcaktuar nga paragrafi 63.2 i nenit 63 të Rregullores së Prokurimit Publik nr. 01/2022, si dhe sipas interpretimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), në pyetjen nr. 8 të datës 22.11.2022.

Në bazë të dispozitave të lartpërmendura, afati për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim është tri (3) ditë, me mundësinë e zgjatjes për edhe tri (3) ditë të tjera, me kusht që OE të njoftohet për këtë zgjatje. Në rastin konkret, AK ka publikuar vendimin e refuzimit me gjashtë (6) ditë vonesë, pa e njoftuar ankuesin për zgjatjen e afatit, ndërsa vendimi është publikuar më 08.07.2025, pra nëntë (9) ditë pas paraqitjes së kërkesës, duke tejkaluar çdo afat ligjor. Rrjedhimisht, sipas ligjit, kërkesa e OE do të duhej të konsiderohej e aprovuar në heshtje pas kalimit të afatit prej tre (3) ditësh.

Për më tepër, edhe nëse merret në shqyrtim vendimi i vonuar, ky vendim i AK është i pa bazuar në ligj dhe i pambështetur në fakte, pasi AK nuk ka arritur të ofrojë kundër-argumente lidhur me pretendimet tona ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, dhe as lidhur me kërkesat e vetë AK të parashikuara në Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe Dokumentet e Tenderit (DT).

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim, pas vonesës prej gjashtë (6) ditësh, cenon rëndë sigurinë juridike të ankuesit për ushtrimin e të drejtës së ankimit brenda afatit ligjor. Edhe pse vendimi është jashtë çdo afati ligjor dhe si i tillë i jashtëafatshëm, AK, përmes vendimit dhe arsyetimit të tij, dëshmon mungesën e trajtimit të drejtë dhe ligjor të pretendimeve tona ankimore. Me këtë veprim, AK tejkalon kompetencat dhe autorizimet e saj, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 51, paragrafet 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke aplikuar kritere shtesë të paparashikuara në NJK dhe DT.

Në mënyrë të veçantë, duke iu referuar arsyetimit të vendimit të AK të datës 08.07.2025, në faqen 4 të tij, konstatohet se AK, për shkak të mungesës së kundër-argumenteve konkrete, i referohet dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, pa specifikuar se cilat dispozita ligjore rregullojnë çështjen në fjalë. Ky arsyetim i përgjithshëm, arbitrar dhe subjektiv, është përtej çdo kërkese të përcaktuar në DT dhe NJK, duke dëshmuar edhe një herë qasjen joprofesionale dhe tendencioze të AK ndaj trajtimit të ofertës sonë, shih arsyetimin:

> Përgjigje:
> Bazuar në Ligjet që janë në fuqi në Republikën e Kosovës, asnjë Operatorë Ekonomik nuk lejohet të lëshojë certifikatë të ekzaminimit nëse nuk është i certifikuar sipas standardeve respektive.

Përveç përgjigjes se pa arsyeshme dhe pa mbështetje ligjore te lartë cekur, AK prapë edhe ne këtë fazë tenton të shtrembëroj kërkesat e NJK dhe DT, sepse nuk është kërkuar pajisja Prova në përdredhje për përcaktimin e φ dhe C në NJK dhe FDT, madje edhe ne ketë përgjigjeje të AK, as kund nuk ceket se pajisja e tille është paraparë ne NJK dhe FDT, shih përgjigjen e AK sa i përket fakteve te rastit:

Pretendimi se pajisjet për ekzaminim të provave në përdredhje nuk janë kërkuar ne FTD dhe NJK nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues në Dosje të tenderit dhe në njoftim për kontrate në nenin 9.1 dhe 9.2 te Kapaciteti teknik dhe profesional, ndër tjera ka kërkuar "4.Kërkesat minimale për veglat, hapësirat ose **pajisjet teknike**...", ndërsa te "Dëshmia e kërkuar dokumentare" është kerkuar "4.Operatori ekonomik **duhet te ofroj dëshmi** përmes listës se dhënë, fotove apo dokumentacionit tjetër **se posedon mjetet, stabilimentet**..." (nga dosja e tenderit është marr vetëm teksti i cili ka të bëjë me çështjen për të cilën është fjala dhe koncentrimi i çështjes të vendoset në pikat respektive).

Në vijim, theksojmë se edhe në këtë fazë të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues (AK) ka kryer shkelje të qarta dhe të rënda të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Për pasojë, vendimi i AK është thellësisht i paqëndrueshëm dhe i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Qëllimi i paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim është pikërisht vendosja e AK-së në pozitë që të mund të korrigjojë vendimet e veta të kundërligjshme. Në rastin konkret, bëhet fjalë për shkelje substanciale të dispozitave ligjore të lartcekura, si dhe për shkelje të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) nr. 2025/0101, i cili ka të bëjë me të njëjtin rast dhe me të njëjtat palë, sa i përket eliminimit të konsorciumit tonë nga procedura e prokurimit.

Për më tepër, duke qenë se AK nuk ka nxjerrë vendim brenda afatit ligjor për miratim ose refuzim të kërkesës për rishqyrtim, pretendimet tona ankimore dhe shkeljet ligjore të kryera nga AK mbeten të plota dhe të pandryshuara. Rrjedhimisht, qëndrojmë plotësisht prapa kërkesës sonë për rishqyrtim të datës 29.06.2025, njësoj sikur të mos ishte nxjerrë vendimi i datës 08.07.2025 nga AK.

Në vazhdim, do të trajtojmë në mënyrë të detajuar pretendimet tona në Ankesë, të cilat janë të njëjta me ato që kemi paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim të datës 29.06.2025.

Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: **Sa i përket B42 Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm - eliminuar) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe**

AK, qëllimshëm dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 51, paragrafit 1 dhe 2 të LPP-së, eliminon ofertën tonë, në shkelje të kritereve të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT edhe ne fazën e ri-vlerësimit të ofertave.

Pretendimi i dytë (ne kërkesën për rishqyrtim pretendimin i parë): Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit kinse për Pajisjen në Prova për përdredhjeje, ku edhe pas ri-vlerësimit të Ofertave dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së 2025/0101, arsyetohet si ne vijim:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshme:

☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 59 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

- Ju mungon dëshmia se nënkontraktori CNG S.r.l. me seli ne Romë - Itali e posedon Pajisjen për Prova ne përdredhje. Ne oferte ne asnjë dokument nuk dëshmoni se i posedoni pajisjet e cekura me lart ku mund te shihet tipi i pajisjes me numër serik te aparaturës si dhe kalibrimi dhe dëshmia se CNG S.r.l. është pronari i pajisjes.
  Ne përgjigjen e pranuar nga ju (Geokos A&A) të datës 12.12.2024 keni dërguar një foto te një Pajisjeje e cila nuk vërteton se është për provat ne përdredhje, me ketë rast e keni vene ne lajthitje edhe Ekspertin Shqyrtues të OSHP-se dhe Panelin shqyrtues të OSHP-se, pra fotoja te e cila jeni thirrur se është për prova ne përdredhje ne fakt nuk vërteton se është për këto prova.

Arsyetimi i AK është i pa qëndrueshëm dhe në shkelje të dispozitave të lartë cekura, për shkak se ka bërë tejkalim të Kompetencave dhe autorizime, për me tepër shih arsyetimin e AK, ku ende nuk e ka të qarta kriteret e përzgjedhjes të paraparë vet nga AK në NJK dhe DT, shih faktet e rastit:

Faktet e rastit:

Kërkesa:4. *Kërkesat minimale për veglat, hapësirat ose pajisjet teknike. OE duhet te posedoj*
-Pajisje për shpim me rrotullim dhe me bërthamë-marrje kontinuale me diametër O =101-146 mm me thellësi deri h=300;
-Laboratorët duhet te jene te akredituara nga organet përkatëse dhe se pajisjet e përfshira ne laboratorë duhet te jene te kalibruara. Ne lidhje me ketë OE duhet ta prezantoj certifikatën përkatëse te kalibrimit.
-Cilindër me gjatësi l=1000 mm për marrje të kampionëve të paprishur për shqyrtime gjeomekanike;
-Laborator për shqyrtime gjeomekanike të dheut;
-Laborator për analiza laboratorike të qymyrit dhe dheut;
-Software për llogaritjen e qëndrueshmërisë së shpateve për llogaritjen në formë rrethore dhe poligonale të rrafshit rrëshqitës;
-Pajisjet për marrje, përgatitje, përpunimin dhe analizë kimike elementare teknike të plotë të qymyrit;

Vërejtje ose OE duhet te dëshmoj se ka pajisje ekuivalente ose me te avancuara për kryerjen e këtyre shërbimeve;

Dëshmia: 4. *Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi përmes listës se dhënë,* ***fotove*** ***apo*** *dokumentacionit tjetër se posedon mjetet, stabilimentet ndërsa lidhur me kalibrimin e pajisjeve te laboratorit, OE duhet ta prezantoj certifikatën përkatëse te kalibrimit.*

Pra, ne rastin konkret, AK, të kriteret e përzgjedhjes nuk ka paraparë një pajisje të tillë në FDT dhe NJK dhe, përderisa Pajisja nuk është paraparë në FDT dhe NJK, është shkelje e dispozitave të nenit 51, paragrafit 1 dhe 2 të LPP-së.
Pajisja ne fjalë është parapare të specifikat teknike te DT dhe e cila do duhej të përfshihej si pjese e kontratës dhe jo si kriter i përzgjedhjes, pra në ketë rast kemi interpretim tërësisht te gabuar nga ana e AK.

Madje, kriteret e përzgjedhjes janë qenësorë për një vlerësim të drejtë dhe meritor, për faktin se janë kusht administrativ, ku DT përbën dokumentin qenësor të aktivitetit të prokurimit dhe për hire të sigurisë juridike, me paragrafin 3 të nenit 7 të LPP-se, çdo AK i ndalohet shprehimisht çdo shmangieje nga termat dhe kriteret e precizuara në DT, sepse, sipas paragrafit 1, të nenit 27 kanë karakter material, kurse devijimi eventual atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP-së.

Për me tepër, po t'i ishte kërkese e FTD dhe NJK, ne prapë do te ishim ne përputhje te plotë me kërkesat e AK, për shkak se ne si GOE kemi ofruar pajisjen sipas specifikimit teknik të AK në Aneksin 1, tabela nr.2, në numrin rendor 18. Prova në përdredhje për përcaktimin e φ dhe C, ku i kemi bashkëlidhur Foton e pajisjes dhe Certifikatën e Kalibrimit, shih provën: .

Provë: Foto e pajisjes dhe Certifikatat e Kalibrimit!

Po t'i referohemi arsyetimit të AK në letrën standarde të eliminimit të konsorciumit tonë, vërtetohet për një tendencë të qëllimshme, jo etike dhe jo profesionale, ne shkelje të dispozitave të nenit 59, paragrafit 2 të LPP-se, dispozitave të nenit 40, par 40.12 dhe 40.13 të Rrpp 01/2022 si dhe në shkelje të vendimit të OSHP-se, nr. 2025/0101, sepse AK, nuk ka mundur të ofroj as edhe një argument të besueshëm se pajisa nuk i plotëson kërkesat e AK ne aspektin teknik.

Po ashtu edhe në e ri-vlerësimit por tani edhe ne fazën e rishqyrtimi AK, ka tendencë të qëllimshme të shtrembëroj faktet, kur arsyetohet se, kemi ve ne lajthitje edhe Ekspertin Shqyrtues edhe Panelin shqyrtues, gjë që nuk është e vërtetë dhe për me tepër është jo profesionale dhe tendencioze, ngase me ane te vendimit të OSHP-se dhe provave të bashkëlidhura me rastin e dorëzimit te tenderit, sqarimeve shtese dhe provave ne ankesën fillestare dëshmoje katërçipërisht, se Konsorciumi ynë i plotëson në tersi kërkesat e parapara në NJK dhe DT, për faktin e pa kontestuar se jemi të përgjegjshëm dhe në përputhje të plotë me kriteret e përzgjedhjes, e vërtetuar ne ekspertizë dhe ne vendim te OSHP-se te lartë cekur.

Madje, arsyetimi i AK, se, pajisja e ofruar nga konsorciumi ynë, është ofruar vetëm me **foto** dhe nuk kemi ofruar tipin dhe numrin serik të aparaturës, është tërësisht i pa qëndrueshëm, sepse AK nuk ka kërkuar, që, pajisja gjatë dorëzimit të tenderit te ofrohet edhe **tipi dhe numri serik i aparaturës,** por foto **apo** dokumentacionit tjetër dhe Certifikatën e kalibrimit, te cilat janë ofruar nga ana jonë sipas provës se lartë cekur, vetë kërkesa e AK ka qene **APO** dhe, cila do nga dëshmitë që do të ishin ofruar Foto apo dokumentacion tjetër duhet te pranohet nga ana e AK, madje nuk ka rendësi se nga cili anëtare i konsorciumit është ofruar pajisja, mbi te gjitha pajisja është ofruar në përputhje të plotë sipas kërkesave teknike te AK.

Po ashtu në përgjigjen e AK, në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, se, nuk kemi ofruar dëshmi për pajisjen nen përdredhje nga nënkontraktori CNG s.r.l, Romë Itali, nuk qëndron, ngase dëshmia është ofruar me foto dhe sipas kërkesave të NJK dhe DT, shih me lartë provën e lartë cekur.

Si do qoftë AK, në asnjërën nga këto momente nuk ka vepruar konform legjislacionit në fuqi dhe vendimit te OSHP, kështu që, AK, veproj ne kundërshtim me frymën dhe qëllimin e LPP-se dhe në shkelje të kritereve të përzgjedhjes, sepse, pa drejtësisht dhe ne mënyre tendencioze eliminon ofertën tone nga aktiviteti i prokurimit edhe pse jemi të përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar çmimin me te ulet sipas kritereve për dhënie te kontratës te tenderuesit të përgjegjshëm, prandaj arsyetimi i AK për eliminim të konsorciumit tonë është i pa qëndrueshëm!

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej te drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëllojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret, sepse Autoriteti kontraktues duhet t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente dhe jo të diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik por të veproj ne përputhje me dispozitat e nenit 7 të LPP-se.

Te gjitha këto dispozita të lartë cekura të shkelura nga ana e AK, nuk mund të kalojnë pa pasoja juridiko penale, sepse qëllimisht po u mohohet e drejta legjitime GOE të lartë cekur si palë të vetme me interes juridiko material për të fituar këtë të drejtë që i jap Ligji i Prokurimit publik në Kosovë, prandaj Njoftimi i AK për eliminim dhe tani ne ketë fazë të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, vendimin e benë të pa qëndrueshëm dhe jo ligjor.

<u>Pretendimi i tretë</u> (ne kërkesën për rishqyrtim pretendimi i dytë) : Njoftimi i Vendimit te AK për anulimin e tërësishëm të aktivitetit të Prokurimit, të dt. 25.06.2025

Vendimi i AK për anulimin e Aktivitetit të Prokurimit bie ndesh edhe me dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht nenin 62 dhe dispozitave të nenit 43, par 43.5 dhe 43.7 të RrPP 01/2022, ku dispozitat ligjore përcaktojnë se ne cilat raste dhe ne cilat situata duhet te anulohet një tender.
Ne vijim **citojmë dispozitat e LPP-se, nenit 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**:

- ✓ *Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*
  1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

- ✓ *Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*
  2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
  2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Nëse referohemi ne dispozitat ligjore të LPP-se, AK nuk ka të drejtë të Anuloj në tersi aktivitetin e Prokurimit, kur ka operator të përgjegjshëm siç jemi ne GOE "GEOKOS A & A O.P" Prishtinë, e konstatuar edhe me ane te ekspertizës se ekspertit shqyrtues dhe vendimit te Panelit Shqyrtues të OSHP-se.

Në as një nga dispozitat e këtij ligji dhe Rregullores 01/2022, nuk e parashohin një situate të tille të anulimit te aktivitetit të prokurimit, për faktin se provat e dëshmuara me rastin e dorëzimit të tenderit e vërtetojnë se jemi në përputhje të plote me kërkesat e AK dhe jemi të përgjegjshëm.

Bazuar ne dispozitat ligjore të parapara në LPP, AK nuk mund të anuloj aktivitetin e prokurimit kur ka OE të përgjegjshëm dhe brenda buxhetit të AK dhe që pretendimet e AK për të anuluar në tersi aktivitetin e prokurimit është i pa qëndrueshëm dhe ne shkelje te ligjit.

Për me tepër, referuar dispozitave te lartë cekura te shkelura nga ana e AK, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore ku AK, ka bërë shkelje të renda të nenit 97, par 97.1, germa (d) duke mos respektuar parimet themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP, trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, germa (h) mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe germa **(p) Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP.**

Meqenëse, OE Instituti "Inkos" Sh.A, tani me nuk është palë me interes juridiko material, pasi që nuk ka shfrytëzuar të drejtën kërkesës/ankesës dhe për me tepër është i papërgjegjshëm edhe sipas vendimi te OSHP-se të lartcekur, nuk është e nevojshme të lëshohemi serish në pretendime ankimore te specifikuara ne kërkesën/ankesën fillestare!

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, madje, nuk kemi pranuar vendim për aprovim apo refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga AK, brenda afateve ligjore, atëherë, kërkojmë nga OSHP-ja, që ankesën të trajtoj me pajtueshmëri më dispozitat ligjore të LPP-se, njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit, vendimit të OSHP-se nr. nr.2025/0101, interpretimit të KRPP-se e që me këtë rast **OSHP-ja**, të nxjerr:

VENDIM

Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj kërkesën për rishqyrtim të bazuar të paraqitur nga **GOE "Geokos A&A O.P. ; Horn and Co. Analytics SH.P.K.**

- ✓ Të hedhe poshtë si të palejuar vendimin e AK për refuzim te kërkesës për rishqyrtim si të jashtë afatshme;
- ✓ Të anuloj njoftimin B42 letrën standarde për tenderuesin e eliminuar;
- ✓ Të anuloj njoftimin B58 për anulimin e tërësishëm të aktivitetit;

Te kthej rastin ne Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të behet me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm **GOE "GEOKOS A & A O.P Horn and Co. Analytics SH.P.K."** Prishtinë

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.
Me respekt,
Gent Muçolli

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Sigurimi i Tenderit, Dokumentet për përgatitjes e tenderit për konkurrim Ankesat, Dëmit ekonomik dhe financiar i fitimit të planifikuar shumës se projektit 10% dhe Humbja e imazhit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
h) Prova: Dëshmia e pajisjes dhe certifikatat e kalibrimit!

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*